

PIK Shpk
L12316016A
Rruga Pjetër Bogdani, Nr. 37
PASQYRA FINANCIARE 2021

**Pasqyrat financiare
dhe Shënimet Shpjeguese
për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021**

PIK Shpk
L12316016A
Rruga Pjetër Bogdani, Nr. 37
PASQYRA FINANCIARE 2021

PËRMBAJTJA

	FAQJA
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	3
PASQYRA PERFORMANCËS	4
PASQYRA E KAPITALIT	5
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE	6
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE	7-20
PASQYRA STATISTIKORE	21-22

Pasqyra e Pozicionit Financiar për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2021*(Vlerat janë shprehur në LEK)*

	Shenime	Më 31 dhjetor 2021	Më 31 dhjetor 2020
AKTIVET			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	904,209	39,129,210
Kërkesa për arkëtim tregtare	5	39,283,202	34,929,550
Kërkesa për arkëtim tatimore	6	945,491	-
Të tjera kërkesa për arkëtim	6	70,000	745,402
Inventarë	7	-	-
Parapagime dhe shpenzime të shtyra	8	10,627,949	6,637,764
Totali i aktiveve afatshkurtra		51,830,851	81,441,926
Aktive afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	9	5,193,272	2,074,153
Të tjera kërkesa për arkëtim	8	10,377,327	-
Totali i aktiveve afatgjata		15,570,599	2,074,153
Totali i aktiveve		67,401,450	83,516,079
DETYRIMET			
Detyrimet afatshkurtra			
Llogari të pagueshme tregtare	10	26,695,120	43,330,785
Detyrime tatimore dhe pagat	11	2,301,660	2,794,739
Të tjera detyrime	12	136,774	316,992
Detyrime ndaj palëve të lidhura	12	3,539,700	-
Detyrime për dividendin	13	10,998,945	4,570,592
Totali i detyrimeve afatshkurtra		43,672,199	51,013,108
Detyrimet afatgjata			
Huamarrje afatgjate	14	500,906	1,359,602
Detyrime tatimore të shtyra		-	-
Totali i detyrimeve afatgjata		500,906	1,359,602
KAPITALI			
Kapitali i nënshkruar	15	250,000	250,000
Rezerva statutore	15	2,050,000	2,050,000
Rezerva të tjera	15	20,000,000	20,000,000
Fitim /Humbje të mbartura	15	799,617	799,617
Fitim /Humbje Ushtrimore	15	128,728	8,043,752
Totali i kapitalit		23,228,345	31,143,369
Totali i detyrimeve dhe kapitalit		67,401,450	83,516,079

Shënimet shpjeguese në faqet 7- 20 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

PDI
L12316016A
PJETER BOGDANI, NR. 37

Pasqyra e Performancës për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2021

(Vlerat janë shprehur në LEK)

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
I. Të ardhurat		
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	16	103,972,782
Të ardhura të tjera	16	1,258,144
Total të Ardhurat (I)		105,230,926
II. Shpenzime		
Shpenzime direkte për mallrat dhe shërbimet e realizuara	17	(68,405,489)
Shpenzime të personelit	18	(25,908,089)
Shpenzime të përgjithshme dhe administrative	19	(5,005,900)
Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale	10	(1,172,704)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	19	(3,303,074)
Total shpenzimet		(103,795,256)
Fitim Humbja nga veprimtaritë kryesore (I+II)		1,435,670
III. Të ardhura dhe shpenzime financiare		
Të ardhura dhe shpenzime nga interesat	20	(17,002)
Të ardhura dhe shpenzime nga kurset e këmbimit	20	(283,543)
Komisione Banke	20	(200,367)
Të ardhura (shpenzime) financiare neto (III)		(500,912)
Fitimi para tatimit (I+II+III)		934,758
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	21	(806,030)
Fitimi (Humbja) e Vitit		128,728
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:		
Diferencat e këmbimit në përkthimin e operacioneve të huaja		-
Fitim/(humbje) në rivlerësimin e pronës		-
Fitim/(humbje) në aktivet financiare të disponueshme për shitje		-
Pjesa e të ardhurave gjithëpërfshirëse të pjesëmarrjeve		-
Të ardhura të tjera totale gjithëpërfshirëse për vitin		-
Të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin		128,728
Fitim/(humbje) i atribueshem për:		
Pronarët e shoqërise mëmë		128,728
Interesa jo-kontrolluese		-
Fitimi/(humbja) për vitin		128,728
Të ardhura/(humbje) totale të atribueshme për:		
Pronarët e shoqërise mëmë		128,728
Interesa jo-kontrolluese		-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		128,728

Shënimet shpjeguese në faqet 7- 20 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

PUB
12316016A
ETER BOGDANI, NR. 37

Pasqyra e Kapitalit për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2021

(Vlerat janë shprehur në LEK)

Balanca e hapjes	Kapitali i regjistruar	Rezerve ligjore	Rezerva statutore	Rezerva tjera	Fitime të mbajtura	TOTAL
Më 01 Janar 2020	100	-	1,250,000	-	29,496,787	30,746,887
Fitimi/(Humbja) e vitit	-	-	-	-	8,043,752	8,043,752
Shtim Kapitali	149,900	-	-	-	(149,900)	-
Fitimi/(Humbja) të pashpërndara bashkimi me përthithje	-	-	-	-	-	-
Shtim Kapitali nga bashkimi me përthithje	100,000	-	-	-	-	100,000
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse	250,000	-	1,250,000	-	37,390,639	38,890,639
Transferim në rezervë	-	-	800,000	20,000,000	(20,800,000)	-
Dividend të paguar	-	-	-	-	(7,747,270)	(7,747,270)
Më 31 Dhjetor 2020	250,000	-	2,050,000	20,000,000	8,843,369	31,143,369
Më 01 Janar 2021	250,000	-	2,050,000	20,000,000	8,843,369	31,143,369
Fitimi/(Humbja) e vitit	-	-	-	-	128,728	128,728
Shtim Kapitali	-	-	-	-	-	-
Fitimi/(Humbja) të pashpërndara bashkimi me përthithje	-	-	-	-	-	-
Shtim Kapitali nga bashkimi me përthithje	-	-	-	-	-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse	250,000	-	2,050,000	20,000,000	8,972,097	31,272,097
Transferim në rezervë	-	-	-	-	-	-
Dividend për tu paguar	-	-	-	-	(8,043,752)	(8,043,752)
Më 31 Dhjetor 2021	250,000	-	2,050,000	20,000,000	928,345	23,228,345

Shtimet shpjeguese në faqet 7 - 20 janë pjesë përbërëse e kësaj pasqyre financiare.



Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2021

(Vlerat janë shprehur në LEK)

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Flukse monetare nga veprimtari shfrytëzuese:		
Fitimi para tatimit	934,758	9,805,324
<i>Rregullime për:</i>		
Amortizimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo-materiale	1,172,704	511,920
Humbjen nga kembimet valutore	-	-
Të ardhurat nga interesi	-	-
Shpenzimet për interesa	-	-
Shpenzimet për Tatim fitim	(806,030)	(1,761,572)
<i>Fitimi operativ para ndryshimeve në kapitalin punues</i>	<u>1,301,432</u>	<u>8,555,672</u>
Zvogëlimi / (ritja) e inventarëve	-	-
Zvogëlimi / (ritja) e kërkesave për arkëtim	(17,239,732)	124,543
(Zvogëlimi) / ritja e llogarive të pagueshme	(17,308,962)	32,729,930
	<u>(34,548,694)</u>	<u>32,854,473</u>
Interes i arkëtuar	-	-
Tatim fitimi i paguar	(1,751,521)	(271,708)
Paraja neto nga aktivitetet operative	<u>(34,998,783)</u>	<u>41,138,437</u>
Flukse monetare nga veprimtaritë investuese:		
Mjete monetare nga bashkimi me përthithje	-	2,326,050
Cash Flow i gjeneruar nga bashkimi me përthithje	-	(1,056,412)
Blerje e aktiveve afatgjata materiale	(4,291,823)	(1,596,400)
Blerje e aktiveve afatgjata jo-materiale	-	-
Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	-	-
Paraja neto nga aktivitetet investuese	<u>(4,291,823)</u>	<u>(326,762)</u>
Flukse monetare nga veprimtaritë financiare:		
Shtim kapitali nga bashkimi me përthithje	-	100,000
Arkëtime nga derdhja e kapitalit	-	-
Arkëtime nga huamarrjet dhe qiratë financiare	3,539,700	1,359,602
Pagese për huamarrjet dhe qiratë financiare	(858,696)	(903,053)
Pagesë Dividendi	(1,615,399)	(3,060,652)
Paraja neto veprimtaritë financiare	<u>1,065,605</u>	<u>(2,504,103)</u>
Pakësimi neto i mjeteve monetare	<u>(38,225,001)</u>	<u>38,307,572</u>
Mjete monetare dhe ekuivalente me to në fillim të vitit	39,129,210	821,638
Mjete monetare dhe ekuivalente me to në fund të vitit	<u>904,209</u>	<u>39,129,210</u>


Shënimet shpjeguese në faqet 7 - 20 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Administratori
Alban Fejzaj

Hartuesi i Pasqyrave Financiare

Alban Fejzaj

PIK
L12316016A
PJETER BOGDANI, NR. 37

Elina Sokri


1. Informacion i përgjithshëm

PIK Sh.p.k. (referuar si “Shoqëria”) është regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) më datë 16 Nëntor 2011.

Veprimtaria e Shoqërisë rregullohet në përputhje me dispozitat përkatëse të Ligjit 9901, datë 14 prill 2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, si dhe nga statuti i saj. Aktiviteti i shoqërisë konsiston në:

- o Ofrimi i shërbimeve grafike, dizenjim, editori, dizenjim faqe web, grafike multimediale, fushata promotionale prodhimesh, fushata sociale, packaging, reklama, ilustrime, broshura, katalogje elektronike dhe aktivitete të tjera në fushën e grafikes, dizenjim realizime mediatike dhe marrëdhënie me publikun, organizim eventesh, tregti materiale për organizim eventesh ndriçim, foni, dekorime, konsulence për organizim eventesh, ide për marketing dhe të gjitha aktivitetet e tjera financiare të lidhura me përmbushjen e objektit të shoqërisë.
- o Agjensi publicitare, marketing, blerje në media, planifikim buxheti mediatik, konsulencë në fushën mediatike, organizim dhe drejtëm të aktiviteteve promotionale dhe reklamuese, organizim dhe financim/sponsorizim i eventeve të ndryshme. Në përputhje me legjislacionin shqiptar, në mënyrë që të arrihet qëllimi i sipërpërmendur, shoqëria mund:
- o Të kryej cdo aktivitet publikimi tregtar, financiar, dhënie - marrje me qira, të vendosë pengje dhe barrë hipotekore; aktivitete keto të konsideruara si të dobishme apo të nevojshme për të arritur qëllimin e shoqërisë dhe që nuk tejkalojnë në masë aktivitetet kryesore, të sipërcituara.
- o Të kryej aktivitete publikimi dhe reklamimi. Shoqëria kryen çdo lloj aktiviteti që bën pjesë në objektin e saj që lidhen me të dhe që e mbështet atë. Shërbime monitorimi të medias dhe analiza mediatike. Konsulencë në menaxhim dhe administrim. Konsulencë në plane biznesi profesionale, planifikim financiar, analize konkurrence. Konsulencë në fushën e marketingut për zhvillim tregu dhe rritje të shitjeve. Konsulencë në zhvillime të produkteve dhe shërbimeve. Konsulencë për Web Zhvillim, Internet Marketing, IT Services.
- o Çdo aktivitet tjetër biznesi i cili nuk është i ndaluar nga ligji i zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë.

Kapitali i regjistruar i shoqërisë është 250,000 lekë i përbërë nga 4 (katër) kuota sipas:

- Alban Fezaj, që zotëron 24% kuota me vlerë nominale 60,000 lekë.
- Ardit Koleci, që zotëron 12% kuota me vlerë nominale 30,000 lekë.
- Glon Bakalli, që zotëron 24% kuota me vlerë nominale 60,000 lekë.
- Petrit Saraili, që zotëron 40% kuota me vlerë nominale 100,000 lekë.

Selia e Shoqërisë ndodhet në **Rruga Pjetër Bogdani Nr.37, Kati 2, Tiranë**. Përfaqësues ligjor i shoqërisë është **Z. Alban Fezaj**.

Numri i punonjësve të Shoqërisë më 31 dhjetor 2021 është **22 (njëzet e dy)** punëmarrës dhe **1 (një)** praktikant.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Përputhshmëria

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK) dhe ligjin nr. 25/2018, datë 10 maj 2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Në bazë të urdhrit nr. 64 datë 22.7.2014 “Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre”, Ministria e Financave vendosi të bëjë të

Shënimet shpjeguese për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Vlerat janë shprehur në LEK)

detyrueshme zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

2.2. Parimi i vijimësisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në parimin e vijimësisë. Të drejtat dhe detyrimet e Shoqërisë më 31 dhjetor 2021 janë paraqitur duke u nisur nga supozimi se Shoqëria do të jetë në gjendje t'i arkëtojë dhe t'i shlyejë këto të drejta dhe detyrime gjatë rrjedhës normale të biznesit.

2.3. Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike me përjashtim të rasteve kur përcaktohet ndryshe.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%, në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.5.3. Gjykime dhe vlerësime mbi efektet e pandemisë në parimet e vijimësisë

Ndërsa situata pandemike COVID-19 ende po evoluon në Shqipëri dhe në mbarë botën, ka pasiguri të lartë mbi shtrirjen e saj në kohën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare. Si pasojë, manaxhimi nuk është në gjendje të vlerësojë me siguri dhe të sigurojë një vlerësim sasior të ndikimit të mundshëm të kësaj pandemie në kompani. Ndërsa masat kufizuese vazhdojnë

Shënimet shpjeguese për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Vlerat janë shprehur në LEK)

volumi i shitjeve, fluksi i parasë, (zhvlerësimi i aktiveve, inventari, vlera e drejtë, etj.) dhe fitimi mund të ndikohen. Sidoqoftë, në datën e këtyre pasqyrave financiare, kompania po operon, vazhdon të përmbushë detyrimet e saj në kohën e duhur dhe për këtë arsye vazhdon të zbatojë parimin e vijmësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare.

3. Politikat kontabël kryesore

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në periudhat e paraqitura, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe.

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 është detajuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
EUR/Lek	120.76	123.7
USD/Lek	106.54	100.84

3.2 Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitetet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare dhe ekuivalente me to përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit. Mjete monetare dhe ekuivalentet me to maten mbarten me koston e amortizuar në pasqyrën e pozicionit financiar.

Llogari të arkëtueshme tregtare

DIK
L12316016A
PJETER BOGDANI, NR. 37

Shënimet shpjeguese për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Vlerat janë shprehur në LEK)

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se Shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar dhe mospagesa apo pagesa e vonuar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua me interes të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dheshpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Të tjera

Instrumenta të tjerë joderivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Instrumentet financiare klasifikohen si asetë afashkurtra me përjashtim të rasteve kur Shoqëria ka një të drejtë pa kusht për ta shtyrë pagesën e detyrimit për të paktën 12 muaj pas datës së bilancit.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalenteve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave përafrohen me vlerat e tyre kontabël për shkak ose të natyrës së tyre afatshkurtër ose të normës së interesit e cila i përafrohet normës së tregut.

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivët financiarë të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivët e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor. Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivët financiarë të matur me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3 Aktive afatgjata materiale

PIK
L12310/2021
RJETER BOGDANI, NR. 37

Shënimet shpjeguese për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Vlerat janë shprehur në LEK)

Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin, nëse ka, dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që Shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit. Metodatat dhe përqindjet e amortizimit të aktiveve afatgjata për periudhën 2021 dhe 2020 janë si më poshtë:

Mobilje dhe orendi	Mbi vlerën kontabël neto	20%
Pajisje Informatike	Mbi vlerën kontabël neto	25%
Mjete transporti e të tjera	Mbi vlerën kontabël neto	20%
Aktive afatgjata jomateriale	Lineare	5%

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

3.4 Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

Shoqëria i njeh të ardhurat nga kryerja e shërbimeve në përpjesëtim me fazën e përfundimit të shërbimit në datën e raportimit. Faza e përfundimit të shërbimeve vlerësohet mbi ecurinë e punëve të kryera.

3.5 Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe



Shënimet shpjeguese për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Vlerat janë shprehur në LEK)

fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.6. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

Shoqëria ka vetëm qira operative. Pagesat e qirasë operative njihen në pasqyrën e performancës me metodën lineare përgjatë periudhës së qirasë. Stimujt e qirasë së përfutur njihen në pasqyrë si pjesë integrale e shpenzimit total të qirasë, përgjatë periudhës së qirasë.

3.7. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.8. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2021 është 15% (2020: 15%). Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshem (apo të rikuperueshem) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore. Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet. Aktivitet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshem në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë. Shoqëria nuk ka njohur tatim të shtyrë për humbjet e mbartura fiskale.

3.9. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet shoqërore për pensione, në emër të vet dhe për punonjësit në përputhje me legjislacionin shqiptar. Kostot e kryera për sigurimet në emër të shoqërisë paraqiten në pasqyrën e performancës. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.10. Transaksionet me palët e lidhura

DIK
L12126016A
PJETER BOGDANI, NR. 37

Shënimet shpjeguese për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Vlerat janë shprehur në LEK)

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.11. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerre.

3.12. Aktivët dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

Alban Fejzaj
Administrator

Alban Fejzaj


Shënimet shpjeguese për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Vlerat janë shprehur në LEK)

4. MJETET MONETARE

Mjetet monetare më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Llogari rrjedhëse:		
Lek	365,508	35,502,136
Euro	8,537	3,007,374
Usd	164	-
	374,209	38,509,510
Arka:		
Lek	530,000	619,700
Në monedhë të huaj	-	-
TOTALI	904,209	39,129,210

5. KËRKESA TË ARKETUESHME TREGTARE

Kërkesat e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Klientë	28,875,234	33,621,598
Klientë për fatura viti pasardhës	10,407,968	1,307,952
TOTALI	39,283,202	34,929,550

6. TË TJERA KËRKESA PËR ARKËTIM

Zëri "Të tjera kërkesa për arkëtim" më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Kërkesa për arkëtim tatimore (tatim fitimi)	945,491	-
Të tjera kërkesa për arkëtim	70,000	745,402
TOTALI	1,015,491	-

7. INVENTARI

Për shkak të natyrës së aktiviteteve të kryera nga Shoqëria gjatë viteve 2021 dhe 2020, Shoqëria nuk ka gjendje inventari.

8. PARAPAGIME DHE SHPENZIME TË SHTYRA

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Parapagime	115,360	130,361
Shpenzime të shtyra	10,512,589	6,507,403
TOTALI	10,627,949	6,637,764

P&K
L12316016A
PIETER BODJANI, NR. 37

Shënime shpjeguese për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021*(Vlerat janë shprehur në LEK)***31 dhjetor 2021 31 dhjetor 2020**

Shpenzime të shtyra afatgjata	10,377,327	-
TOTALI	10,377,327	-

9. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE

Aktivet afatgjata materiale më 31 dhjetor 2021 përbëhen si më poshtë:

	Mjete transporti	Pajisje zyrc, mobile	Pajisje informatike	Të tjera	Totali i Aktiveve Fikse
AQT me kosto historike					
Teprica me 1 Janar, 2021	-	2,001,220	3,233,608	27,055	5,261,883
Shtesa nga blerjet	3,605,875	40,429	645,518	-	4,291,823
Shtesa nga bashkimi me përthithje					-
Transferime nga zëra të tjerë		-	-	-	-
Transferime nga bashkimi me përthithje					-
Teprica me 31 Dhjetor, 2021	3,605,875	2,041,649	3,879,126	27,055	9,553,706
Amortizimi i akumuluar					
Teprica me 1 Janar, 2021	-	(1,066,114)	(2,118,911)	(2,705)	(3,187,730)
Shtesa e vitit	(631,028)	(187,256)	(349,787)	(4,633)	(1,172,704)
Shtesa nga bashkimi me përthithje					-
Transferime nga zëra të tjerë					-
Teprica me 31 Dhjetor, 2021	(631,028)	(1,253,370)	(2,468,698)	(7,338)	(4,360,434)
Balanca me 31 Dhjetor, 2021	2,974,847	788,279	1,410,428	19,717	5,193,272

10. LLOGARI TË PAGUESHME TREGTARE

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 përbëhen si më poshtë:

31 dhjetor 2021 31 dhjetor 2020

Furnitorë	23,914,217	43,316,623
Furnitorë për fatura të pambërritura	2,780,903	14,162
TOTALI	26,695,120	43,330,785

11. DETYRIME TATIMORE

Detyrimet tatimore më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 përbëhen si më poshtë:

31 dhjetor 2021 31 dhjetor 2020

Tatim mbi të ardhurat personale	216,228	190,395
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	550,016	427,695
TVSH	18,890	418,675
Tatim në burim	6,176	4,411
Tatim fitimi	-	1,489,863
Detyrime për pagat	1,510,350	263,700
TOTALI	2,301,660	2,794,739

12. TË TJERA DETYRIME

Detyrimet e tjera më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 përbëhen si më poshtë:



Shënimet shpjeguese për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
(Vlerat janë shprehur në LEK)

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Overdraft bankar Intesa SanPaolo	-	316,992
Parapagime të marra	136,774	-
TOTALI	136,774	316,992

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Detyrime ndaj palëve të lidhura	3,539,700	-
TOTALI	3,539,700	-

13. DETYRIME PËR DIVIDENTIN

Shoqëria më 31 dhjetor 2021 ka detyrime për dividendin në vlerën prej 10,998,945 lekë (2020: 4,570,592 lekë).

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Detyrime për dividendin	10,998,945	4,570,592
TOTALI	10,998,945	4,570,592

14. HUAMARRJE AFATGJATË

Shoqëria më 31 dhjetor 2021 ka detyrime për huamarrje afatgjatë në vlerën prej 500,906 lekë.

15. KAPITALI I NËNSHKRUAR

Kapitali i pronarit më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Kapitali	250,000	250,000
Rezerva statutore	2,050,000	2,050,000
Rezerva të tjera	20,000,000	20,000,000
Fitimi/Humbja e pashpërndarë	799,617	799,617
TOTALI	23,099,617	23,099,617

16. TË ARDHURA

Shoqëria ka realizuar të ardhura gjatë vitit 2021 të lidhura me aktivitetin e saj. Shoqëria ka njohur të ardhurat atëherë kur ka konsideruar të mundshme që do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe keto përfitime mund të maten me besueshmeri. Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara. Sipas kësaj metode, efektet e transaksioneve dhe ngjarjeve të tjera janë njohur në pasqyrat financiare kur ato kanë ndodhur (dhe jo kur paraaja ose ekuivalentet e saj janë arkëtuar ose paguar) dhe janë njohur në kontabilitet e raportuar në pasqyrat financiare të periudhave kontabël, të cilave u përkasin. Të ardhurat e shoqërisë gjatë vitit 2021 dhe 2020 paraqiten si më poshtë vijon:

Shënime shpjeguese për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021*(Vlerat janë shprehur në LEK)*

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020
Të ardhura nga shërbimi	103,972,782	146,390,606
Të ardhura të tjera	1,258,144	63,359
Të ardhura nga bashkimi me përthithje	-	8,679,036
TOTALI	105,230,926	155,133,001

Të ardhurat ndahen sipas shërbimeve kryesore të realizuara nga shoqëria gjatë vitit 2021:

Shitje shërbime nga bashkimi me përthithje	-	8,679,036
Shitje shërbime Kreative	28,530,795	32,120,248
Shitje shërbime Digital	3,097,582	7,215,259
Prodhime (production, printime etj.)	5,411,667	6,416,334
Organizim Eventi	18,500,812	4,902,249
Prodhim Shitje Shërbime Audio Visual	26,391,351	47,203,070
Shitje Media Buying	22,040,576	48,533,447
Alokim shpenzimesh	910,228	21,013
Qira	347,916	42,345
TOTAL	105,230,926	155,133,001

17. KOSTO DIREKTE SHËRBIMI

Mallrat dhe shërbimet që lidhen direkt me të ardhurat e përfituara gjatë vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 detajohen si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020
Kosto e mallit të shitur	-	-
Shërbime design dhe kreative	13,413,607	25,031,873
Shërbime organizim event	10,970,695	2,798,157
Shërbime dixhitale	1,339,621	6,724,017
Shërbime printi dhe prodhime	4,449,306	8,358,694
Shërbime realizime video	19,321,531	25,405,551
Shërbime media	18,113,232	41,505,098
Shpenzime nga bashkimi me përthithje	-	6,631,337
Shërbime të tjera	797,497	-
TOTALI	68,405,489	116,454,727

18. SHPENZIME PERSONELI

Shpenzimet e personelit gjatë vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 përbëhet si më poshtë:

PIK
L12316016A
PIETER BOGDANI, NR. 37

Shënimet shpjeguese për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021*(Vlerat janë shprehur në LEK)*

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020
Pagat e personelit	22,480,527	16,588,063
Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	3,427,562	2,456,407
Pagat e personelit nga bashkimi me përthithje	-	538,876
Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore nga bashkimi me përthithje	-	89,992
TOTALI	25,908,089	19,673,338

19. SHPENZIME TË PËRGJITHSHME DHE ADMINISTRATIVE

Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative gjatë vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 përbëhen si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020
Blerje, energji, avull, ujë	383,804	332,251
Shpenzime qira	2,218,259	1,930,732
Shërbime noteriale dhe përkthimi	36,000	67,100
Shërbime interneti	155,633	139,517
Shërbim sigurie	60,000	60,000
Shpenzime certifikimi, anëtarësimi	110,853	-
Shërbim IT	286,080	194,582
Shpenzime kancelarike	135,395	119,140
Shërbime financiare	475,000	500,000
Shërbime konsulence	-	944,050
Transferime, udhëtime, dieta	659,500	382,924
Shpenzime postare dhe telekomunikimi	485,376	387,552
TOTALI	5,005,900	5,057,848

Shpenzimet e tjera gjatë vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 përbëhen si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020
Shpenzime për pritje dhe përfaqësime	970,658	481,720
Shpenzime transporti	222,862	596,026
Blerje/Shpenzime të tjera (kafe, detergjente etj)	124,630	39,895
Taksa, tarifa dhe komisione doganore	2,722	24,606
Taksa dhe tarifa vendore	74,500	464,530
Gjopa dhe penalitete	84,018	74,180
Shpenzime të tjera	1,823,684	1,563,505
TOTALI	3,303,074	3,244,462



Shënimet shpjeguese për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Vlerat janë shprehur në LEK)

20. TË ARDHURA (SHPENZIME) FINANCIARE, NETO

Të ardhurat (shpenzimet) financiare gjatë vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 përbëhen si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020
Të ardhura nga interesa	28,195	57
Shpenzime për interesa	(45,197)	(70,550)
	(17,002)	(70,493)
Fitime të realizuara nga kursi kembimit	177,856	417,305
Humbje të realizuara nga kursi kembimit	(461,399)	(387,137)
	(283,543)	30,168
Komisione bankare	(200,367)	(345,057)
TOTALI	(500,912)	(385,382)

21. TATIM- FITIMI

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin aktual dhe tatimin e shtyrë. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin njihet si fitim ose humbje përveç nëse lidhet me zëra të njohur direkt në kapital, rast në të cilin njihet në kapital. Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke përdorur normen tatimore në fuqi ose që konsiderohet në fuqi në datën e raportimit, dhe çdo sistemim të tatimit të pagueshëm për vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyrë lind nga ndryshimet mes vlerave të njohura për aktivet dhe detyrimet e shoqërisë të paraqitura në pasqyrën e pozicionit financiar në përputhje me kërkesat e SKK dhe vlerave të njohura të këtyre aktiveve dhe detyrimeve nga autoritetet tatimore.

Bazuar në legjislacionin shqiptar, norma e tatimit mbi fitimin është 15 % për vitin 2021.

Deklaratat tatimore dorëzohen çdo vit por të ardhurat dhe shpenzimet e deklaruara për qëllime tatimi konsiderohen vetëdeklarime deri në momentin që autoritet tatimore shqyrtojnë deklaratat dhe regjistrimet e tatimpaguesit dhe bëjnë vlerësimin final. Ligjet dhe rregullat tatimore shqiptare janë objekt interpretimi nga autoritet tatimore.

Për vitet e mbyllura më 31 dhjetor 2021 dhe 2020, Shoqëria ka rezultuar me fitim kontabël dhe fiskal.

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020
Tatim-fitimi	(806,030)	(1,838,360)
TOTALI	(806,030)	(1,838,360)

POK
412316016A
PJETER DOGDANI, NR. 37
19

Shënimet shpjeguese për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Vlerat janë shprehur në LEK)

Rakordimi i fitimit kontabël me fitimin fiskal

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020
Fitimi (humbja) kontabël e vitit	934,758	10,317,244
Rregullime për zëra shpenzimesh të panjohura:	4,438,774	1,938,487
Fitimi (humbja) fiskale e vitit	5,373,532	12,255,731
Shpenzime të Tatim fitimit 2021	(806,030)	(1,838,360)
Fitimi (humbja) fiskale e vitit neto	4,567,502	10,417,371
Parapagim tatim fitim	1,751,521	271,708
Balanca TF për vitin pasardhës/(për pagesë)	945,491	(1,566,652)

Këto pasqyra financiare u aprovuan dhe u nënshkruan nga Drejtimi i Shoqërisë më 30 mars 2022:

Administrator

Alban Fejzaj

Alban Fejzaj
2316016A
PER BOGDANI/NT 77

Shënimet shpjeguese për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Vlerat janë shprehur në LEK)

Aktivët Afatgjatë Materiale me vlerë fillestare 2021

Nr	Emertimi	Gjendje 01/01/2021	Shtesa	Pakesime	Gjendje 31/12/2021
1	Toka				
2	Ndertime				
3	Pajisje zyre, mobilie	2,001,220	40,429		2,041,649
4	Mjete transporti		3,605,875		3,605,875
5	Të tjera	27,055			27,055
6	Pajisje Informatike	3,233,608	645,518		3,879,126
TOTALI		5,261,883	4,291,823	-	9,553,706

Amortizimi A.A.Materiale 2021

Nr	Emertimi	Gjendje 01/01/2021	Shtesa	Pakesime	Gjendje 31/12/2021
1	Toka				
2	Ndertime				
3	Pajisje zyre, mobilie	1,066,114	187,256		1,253,370
4	Mjete transporti		631,028		631,028
5	Të tjera	2,705	4,633		7,338
6	Pajisje Informatike	2,118,911	349,787		2,468,698
TOTALI		3,187,730	1,172,705	-	4,360,435

Vlera Kontabel Neto e A.A.Materiale 2021

Nr	Emertimi	Gjendje 01/01/2021	Shtesa	Pakesime	Gjendje 31/12/2021
1	Toka				
2	Ndertime				
3	Pajisje zyre, mobilie	935,106		146,827	788,279
4	Mjete transporti		3,605,875	631,028	2,974,847
5	Të tjera	24,350		4,633	19,717
6	Pajisje Informatike	1,114,697	645,518	349,787	1,410,429
TOTALI		2,074,153	4,251,394	1,132,275	5,193,271

Administrators

Alban Fejzaj

BOZ
L12316016A
PJETER BOGDANI, NR. 37

Shënimet shpjeguese për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Vlerat janë shprehur në LEK)

PIK Shpk

NIPT L12316016A

Inventari automjeteve në pronesi të subjektit

31.12.2021

Nr.	Lloji i automjetit	Cope	Targa	Vlera
1	Volvo XC40	1	AB 468 BT	3,605,875
Shuma				3,605,875

PIK Shpk

NIPT L12316016A

Inventari ne pronesi te subjektit

31.12.2021

Nr.	Lloji i mallit	Cope	Cmim	Vlera
Shuma				-

Këto pasqyra financiare janë nenshkruar nga Administratori i Shoqërisë, më 30 mars 2021.

Administrator

Alban Fejzaj

Alban Fejzaj
PIK
L12316016A
PJETER BOGDANI, NR. 37